

ENTREPRENEURSHIP AND THE ROLE OF WOMEN ENTREPRENEURSHIP IN ECONOMIC GROWTH

Merita Bakiji

South East European University, N. Macedonia, mb22289@seeu.edu.mk

Abstract: Business or entrepreneurship in recent years has taken on a different dimension than previously considered. In the literature of recent years, entrepreneurship is considered as one of the most important factors of productivity. As such, it has become the object of study of many scholars and at the same time a very attractive field for academic research and more. Understanding the importance of women entrepreneurs in the economy of a country and in society in general, we will discuss the contribution of women in this paper based on various adequate literature on the role of entrepreneurship in general and the impact of women entrepreneurs in economic growth. The paper also provides new knowledge in the field of women entrepreneurship based on the rapid increase in the number of women entrepreneurs in different parts of the world. Although women entrepreneurs usually allude to micro-businesses or small businesses, the number of these businesses has steadily increased with what is known is the fact that economic development depends heavily on small businesses. This increase consists in the fact that women in business have reaped continuous success and their rise or prosperity is a result of some of the qualities that women possess to manage and solve financial problems. For these issues, many studies focus only on analyzing the positive skills of women through which they best cope in leadership and decision-making positions and also their studies focus on women's economic empowerment and increasing women's participation in business. How do women entrepreneurs affect economic growth, what do they offer and provide in the labor market, how has the level of economic growth changed in countries with high levels of women entrepreneurship, and what is the relationship between economic growth and the level of women entrepreneurs, represent the purpose of this paper. So, the object of this research is to clarify the role and influence that women entrepreneurs have in economic growth as a significant variable of economic growth and as one of the determinants of economic growth of a country, however this paper leaves space, opportunity and desire in research in the future, other relevant variables should be included in order to provide accurate and reliable results in terms of analysis of the factors that determine the economic growth and development of a country.

Keywords: Entrepreneurship, women entrepreneurs, economic development, economic growth

SIPËRMARRËSIA DHE ROLI I GRUAS SIPËRMARRËSE NË RRIJTJEN EKONOMIKE

Merita Bakiji

South East European University, N. Macedonia, mb22289@seeu.edu.mk

Abstrakti: Biznesi apo sipërmarrësia vitet e fundit ka marrë një dimension tjetër nga çka është konsideruar më parë. Në literaturat e viteve të fundit, sipërmarrësia llogaritet si një nga faktorët më të rëndësishëm të prodhimit. Si e tillë, ajo është bërë objekt studimi i shumë studiuesve dhe njëkohësisht një fushë shumë atraktive për hulumtime akademike dhe jo vetëm. Duke kuptuar rëndësinë e gruas sipërmarrëse në ekonominë e një vendi dhe në shoqërinë në përgjithësi, kontributin e grave do t'ua shtjellojmë pikërisht në këtë punim duke u mbështetur në literaturat të ndryshme adekuate lidhur me rolin e sipërmarrësisë në përgjithësi dhe ndikimin e gruas sipërmarrëse në rritjen ekonomike. Punimi gjithashtu ofron njohuri të reja nga fusha e sipërmarrësisë së grave duke u mbështetur në rritjen rapide të numrit të grave sipërmarrëse në vende të ndryshme të botës. Edhe pse zakonisht gratë sipërmarrëse aludojnë në mikro biznese ose biznese të vogla, megjithatë numri i këtyre bizneseve është rritur në mënyrë të vazhdueshme me çka ajo që dihet është fakti se zhvillimi ekonomik varet shumë nga bizneset e vogla. Kjo rritje konsiston me faktin që femrat në biznes kanë korrur suksese të vazhdueshme dhe ngritja apo prosperiteti i tyre është rezultat i disa cilësive që posedojnë femrat për të menaxhuar dhe zgjidhur probleme të aspektit financiar. Për këto çështje, shumë studime fokusohen vetëm në analizën e aftësive pozitive të grave me anë të të cilave ato më së miri përballen në pozitën e liderit dhe të vendimmarrjes dhe gjithashtu studimet e tyre përqendrohen në fuqizimin ekonomik të grave dhe në rritjen e pjesëmarrjes së grave në biznes. Se si ndikojnë sipërmarrëset femra në rritjen ekonomike, çfarë ato ofrojnë dhe sigurojnë në tregun e punës, si ka ndryshuar niveli i rritjes ekonomike në vendet me nivel të lartë të sipërmarrësisë së grave dhe si është raporti në mes rritjes ekonomike dhe nivelit të grave sipërmarrëse, paraqesin qëllimin e këtij punimi. Pra, objekti i këtij hulumtimi është sqarimi i rolit dhe ndikimit që ka femra sipërmarrëse në rritjen ekonomike si një variabël signifikante e rritjes ekonomike dhe si një nga determinantet e rritjes ekonomike të një vendi, megjithatë ky punim lë hapësirë, mundësi dhe dëshirë që në hulumtime të ardhshme

të inkuadrohen edhe variabla tjera me relevancë në mënyrë që të ofrohen rezultate të sakta dhe të sigurta për sa i përket analizës së faktorëve që determinojnë rritjen dhe zhvillimin ekonomik të një vendi.

Fjalët kyçe: Sipërmarrësia, gratë sipërmarrëse, zhvillimi ekonomik, rritja ekonomike

1. HYRJE

Sipërmarrja si faktori i katërt i prodhimit paraqet procesin e zbulimit të mundësive të reja dhe marrjes përsipër të rrezikut me qëllim të arritjes së atyre mundësive, përmes përdorimit racional të resurseve në dispozicion. Për të vërtetuar lidhjen dhe ndikimin e sipërmarrësisë në rritjen ekonomike, provat e ndryshme kanë nxjerr konkluzione se sipërmarrësia llogaritet si një “motor” i fuqishëm dhe forca lëvizëse e rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Nga ana tjetër, edhe literaturat për sipërmarrjen e grave po tregojnë një interes të veçantë dhe veçanërisht fokusi i tyre është në analizimin e aftësive dhe karakteristikave të grave që i bëjnë ato të dallueshme nga sipërmarrësit meshkuj. Për shkak se sipërmarrja e femrave merr përmasa globale, hulumtimi ynë bazohet kryesisht në shpjegimin e variablës “sipërmarrësia e grave” në rritjen ekonomike të një vendi. Kërkimet e fundit tregojnë se aktiviteti sipërmarrës i grave është rritur në mënyrë të vazhdueshme vitet e fundit.

2. SIPËRMARRËSIA DHE ROLI I GRUAS SIPËRMARRËSE NË RITJEN EKONOMIK

Në teorinë bashkëkohore ekonomike, përveç faktorëve si puna, toka dhe kapitali, inkuadrohet edhe sipërmarrësia ose aftësitë organizative si një nga faktorët dhe determinantet e rritjes ekonomike (Pollozhani, 2016, p. 161).

Nocioni i sipërmarrjes më së tepërmi ndërlidhet me kompanitë mikro, të vogla dhe ato të mesme të cilat në ekonominë bashkëkohore marrin pjesë me më tepër se 95 % nga numri i përgjithshëm i kompanive dhe të njejtat punësojnë rreth 80 % nga fuqia e përgjithshme e punës (Velkova, Sllavica Kovačevska; Zlatkovski, Zoran, 2010, p. 22).

Për të vërtetuar lidhjen dhe ndikimin e sipërmarrësisë në rritjen ekonomike, provat e ndryshme kanë nxjerr konkluzione se sipërmarrësia llogaritet si një “motor” i fuqishëm dhe forca lëvizëse e rritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Një arsytim tjetër se ndërmarrësia lidhet me rritjen ekonomike është fakti se definicioni i dhënë për ndërmarrësinë e konsideron atë si një lëvizës kryesor në aktivitetin ekonomik (Bannock, Graham; Baxter, R. E.; Davis, Evan, 1998, p. 128). Sipërmarrja është ndikuesi më i mirë i zhvillimit ekonomik dhe ofron mbështetje për të përballuar trendet në rritje të globalizimit (Mucha, 2020). Ndërmarrësia dhe biznesi i vogël paraqesin burim të vendeve të reja të punës. Studimet e fundit në SHBA, Kanada dhe Evropë kanë vënë në dukje se ndërmarrjet e vogla kanë krijuar mundësi të mëdha për punësime të reja. Këto rezultate dëshmojnë kontributin e rëndësishëm që ato e japin për ekonominë kombëtare, në kohën kur mundësitë e reja për punësime shënojnë rritje (Ramadani, Veland; Hisrich, Robert D., 2015, p. 20).

Përveç këtyre, sipërmarrja luan një rol të rëndësishëm në krijimin e mundësive të punësimit për shoqëritë rurale, sigurimin e vetëpunësimit për ata që fillojnë biznesin e tyre dhe përmirësimin e statusit ekonomik të zonës rurale gjithashtu (Guatam, Rakesh Kumar; Mishra, Dr. K., 2016, p. 33).

Sipas Velkova & Zlatkovski, rëndësia e sipërmarrjes mund të shprehet përmes gjashtë karakteristikave të saj:

3. Sipërmarrja si krijuese e bizneseve të reja;
4. Sipërmarrja si krijuese e vendeve të reja të punës;
5. Sipërmarrja si nxitëse e konkurrencës;
6. Sipërmarrja si krijuese e produkteve të reja;
7. Sipërmarrja si faktor për rritjen e produktivitetit;
8. Sipërmarrja si faktor për realizimin e normave të larta të zhvillimit ekonomik (ritje e prodhimit të së përgjithshme) të vendit (Velkova, Sllavica Kovačevska; Zlatkovski, Zoran, 2010, p. 22)

Nga ana tjetër, ekzistojnë edhe kontradikta në lidhje me atë se si perceptohet dhe si llogaritet sipërmarrësia. Kështu, sipërmarrësia nuk konsiderohet si faktor i rëndësishëm për stimulim të ekonomisë, por ajo është pasojë dhe rezultat i zhvillimit lokal socio-ekonomik (Претприемништво-Проблеми, Дилеми и Перспективи-Научен собир, 2007, p. 32).

Sipërmarrëset femra gjithnjë asocojnë biznesin e vogël dhe njëkohësisht biznesin familjar ngaqë në këtë fushë ato paraqiten si iniciatore e disa veprimtarive ekonomike nga të cilat rezultojnë me vetëpunësimin e tyre dhe marrin rolin e sipërmarrësit. Në këtë mënyrë, gratë janë përfaqësuese e atij segmenti të tregut i cili ka shënuar rritje të shpejtë të biznesit të vogël, gjë që ndikon direkt në rritjen ekonomike të një vendi.

Ndërmarrjet familjare ndikojnë pozitivisht në rritjen e përgjithshme ekonomike të një vendi duke rritur inovacionin, duke rritur produktivitetin, duke krijuar mundësi pune, duke zhvilluar industri të reja dhe duke përmirësuar standardet e jetesës (Mucha, 2020). Sipas Velkova dhe Zlatkovski, lidhja ndërmjet sipërmarrjes femërore dhe zhvillimit ekonomik është një lidhje reciproke. Nga njëra anë, zhvillimi ekonomik çon në rritjen e pagave të të

punësuarëve (femra), gjë e cila rezulton me zvogëlimin e dëshirës për hapjen e bizneseve të tyre personale. Ndërsa nga ana tjetër, rritja ekonomike çon në zhvillim të sektorit të shërbimeve, në të cilin sektor femrat ndjehen më të sigurta në udhëheqjen e biznesit personal (Velkova, Sllavica Kovačevska; Zlatkovski, Zoran, 2010, p. 169).

Kohët e fundit, statistika të ndryshme kanë dhënë rezultatet që numri i femrave sipërmarrëse është gjithnjë e më rritje dhe kjo rritje është evidentuar në shumë vende të botës. Megjithatë, ende ekzistojnë shoqëri në të cilat meshkujt janë dominant në sektor dhe fusha të ndryshme dhe në të cilat shoqëri ekziston hendeku gjinor i theksuar në pronësinë e biznesit. Por, një qasje gjinore për të studiuar gratë sipërmarrëse është në konsolidim (Gherardi, Silvia and Perrotta, Manuela, 2016, p. 30).

Sipas statistikave të mbledhura nga GEM (2004), raportohet se gratë përfaqësojnë më tepër se 1/3 e të gjithë njerëzve të përfshirë në veprimtari sipërmarrëse (Durmishi, Ceneta Telak and Bilic, Snezana, 2019, p. 273).

Studimet e bëra në lidhje me sipërmarrësinë e grave në SHBA tregojnë se 1/3 e bizneseve e përfaqësojnë gratë dhe afër 80% e këtyre bizneseve realizohen në sektorin e shitjes me pakicë dhe në sektorin e shërbimeve (Raimi, 2009, p. 36).

Sipas disa studimeve të bëra nga Banka Botërore në lidhje me gruan sipërmarrëse, vendet të cilat kanë raportuar një përqindje në rritje të pronarëve femra janë Azerbejxhani, Gjeorgjia, Kosova, Nepali dhe Omani. Madje është interesante fakti që rritja më e madhe e përgjithshme është vërejtur në Kosovë ku përqindja e bizneseve me pronarë femra është rritur nga 9 përqind në vitin 2012 në 25 përqind në vitin 2016 që është një rritje e konsiderueshme dhe një përparim i madh (Women's Entrepreneurship, 2016/2017, p. 10).

Për të vënë në pah rolin dhe rëndësinë e femrave sipërmarrëse në rritjen ekonomike, theksojnë se ekzistojnë dy arsye se pse femrat sipërmarrëse konsiderohen si objekt i rëndësishëm i studimeve akademike (Fiti, Taki; Ramadani, Veland, 2013, p. 325).

Sipas Ramadani & Fiti, ato krijojnë vende të reja pune për veten dhe për të tjerët, sigurojnë zgjidhje të ndryshme për problemet dhe pengesat që paraqiten gjatë menaxhimit të biznesit, si dhe në shfrytëzimin e mundësive që ofrohen në mjedisin afarist. Po ashtu, femrat janë neglizhuar në mënyrë të vazhdueshme, si nga shoqëria ashtu edhe nga shkencat shoqërore, duke menduar që hulumtimet, politikat, programet dhe bizneset duhet të orientohen vetëm kah meshkujt (Fiti, Taki; Ramadani, Veland, 2013, p. 325).

Duke mos e potencuar dallimin në mes sipërmarrësve femra dhe meshkuj, në përgjithësi, sipërmarrësia mundëson që shoqëritë e tregut të lirë të bëhen më të pasura dhe më dinamike dhe po ashtu u ofron shumicës së njerëzve një jetë më interesante. Ajo i eliminon ato industri të cilat kanë stagnuar duke i zëvendësuar me industri që janë në rritje (Претприемачки алатки-Алатки и техники за почнување и раст на нов бизнис, 2013, p. 15).

Femrat janë të interesuara të fillojnë biznesin e tyre si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane për shkak të tejkallimit të varfërisë, gjenerimit të të ardhurave familjare dhe zhvillimit të standardit të jetesës. Ato po marrin pjesë në bujqësi, biznes dhe tregti pa ndonjë kufizim social (Guatam, Rakesh Kumar; Mishra, Dr. K., 2016, p. 33).

Për më tepër, ekonomitë e vendeve të cilat karakterizohen me nivel të lartë të femrave sipërmarrëse, shoqërohen me një veprimtari sipërmarrëse më elastike ndaj krizave financiare dhe përjetojnë ngadalësime ekonomike më të rrallë (Meunier, Frédéric; Krylova, Yulia; Ramalho, Rita, 2017, p. 2).

Pra, sa më i lartë niveli i zhvillimit ekonomik, aq më shpesh gratë sipërmarrëse raportojnë dëshirën për të rritur biznesin e tyre, duke parashikuar gjashtë ose më shumë punësime në pesë vitet e ardhshme (Women's Entrepreneurship, 2016/2017, p. 35).

3. KONKLUZION

Në këtë artikull, ne synuam që t'i japim shpjegim rolit dhe ndikimit të sipërmarrësisë dhe sipërmarrësisë së grave në rritjen ekonomike të një vendi, duke vënë në pah beneficionet e atyre vendeve që raportojnë nivel të lartë të femrave sipërmarrëse. Ne vërejtëm që vendet që kanë regjistruar rritje të nivelit të femrave sipërmarrëse, janë vendet të cilat njëkohësisht kanë regjistruar edhe rritje të nivelit të rritjes ekonomike. Ne prezantuar bashkëveprimin dhe ndërlidhjen në rradhë të parë mes sipërmarrësisë dhe rritjes ekonomike dhe pastaj me theks të veçantë theksuam raportin e sipërmarrësisë së grave dhe rritjes ekonomike të një vendi. Arsyetimet e këtij bashkëveprimi dhe këtij raporti të ndërsjellë janë faktet që tregojnë se krijimi i vendeve të reja të punës paraqet elementin kyç të rritjes ekonomike. Të gjitha ekonomitë e botës kanë nevojë për sipërmarrësinë për arsyen se një sipërmarrës është krijues i drejtpërdrejtë i bizneseve të reja, i vendeve të reja të punës dhe në këtë mënyrë reduktohet numri i të papunëve në një vend, rritet standardi jetësor dhe përmirësohet mirëqenia socio-ekonomike e një vendi. Po ashtu, gratë me karakteristikat e tyre kreative dhe inovative përbëjnë rëndësi të madhe për zhvillim ekonomik të një shteti. Në nivel global, numri i grave sipërmarrëse është rritur dukshëm vitet e fundit dhe kjo rritje ka rezultuar me rritje dhe zhvillim ekonomik. Kjo nënkupton që mes sipërmarrësisë së femrave dhe rritjes ekonomike ekziston një raport i drejtë, ku me rritjen e numrit të femrave sipërmarrëse rritet edhe niveli i rritjes ekonomike të një vendi.

Ky kontribut është i rëndësishëm për sa i përket implikimeve të tij në shjegimin e këtyre variablave që ndikojnë në rritjen ekonomike dhe hap rrugë për kërkime të reja të ardhshme.

REFERENCAT

- Bannock, G., Baxter, R. E., & Davis, E. (1998). Dictionary of Economics. New edition. Penguin books.
- Durmishi, C. T., & Bilic, S. (2019). Challenges and Opportunities of female Entrepreneurship Development in the Republic of North Macedonia, *KNOWLEDGE-International Journal* Vol. 35.1, 273-276.
- Fiti, T., & Ramadani, V. (2013). Ndërmarrësia. Universiteti i Evropës Juglindore. Tetovë.
- Gherardi, S., & Parrotta, M. (2016). Doughters taking over the family business. *International Journal of Gender and Entrepreneurship* 8(1):28-47.
- Gautam, R. K., & Mishra, K. (2016). Study on rural women entrepreneurship in India: Issues and challenges. *Int. J. Appl. Res*, 2, 33-36.
- Meunier, F., Krylova, Y., & Ramalho, R.. (2017). Women's Entrepreneurship-How to Measure the Gap between New Female and male Entrepreneurs, World Bank Group.
- Mucha, S. (2020), Ethnic Albanian family businesses and COVID-19 pandemic: a gender-based comparison, *Journal of Family Business Management*, Vol. ahead-of-print No. ahead-of-print. <https://doi.org/10.1108/JFBM-07-2020-0074>
- Pollozhani, P. (2016). Hyrje në ekonomi. Për jurist dhe shkencat teknike. Arbëria Design. Tetovë.
- Ramadani, V., & Hisrich, D. R. (2015). Ndërmarrësia & Menaxhimi i Biznesit të Vogël. Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë.
- Velkova, S. K., & Zlatkovski, Z. (2010). Biznesi-Për vitin e IV. Qendra grafika Shpk, Shkup.
- Women's Entrepreneurship, 2016/2017. Policy Research working Paper. Global Entrepreneurship Monitor.
- Претприемачки алатки-Алатки и техники за почнување и раст на нов бизнис, Алатки и техники за почнување и раст на нов бизнис, (2013), Европа 92, Кочани.
- Претприемништво- Проблеми, Дилеми и Перспективи, (2007), Скопје.